



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 09/140
Datë: 05.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Administrimin e Mbeturinave nga Industria e Nxjerrjes së Mineraleve.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Ministry of Environment and Spatial
Planning - Ministarstvo Sredine i Prostornong Planiranja**

**KONCEPT DOKUMENTI ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE NGA INDUSTRIA E
NXJERRJES SË MINERALEVE**

Prishtinë, 2016

Kapitulli 1: Hyrje

Kosova ka një potencial të madh në fushën e xeherorëve dhe pasuritë minerare luajnë një rol kyç në zhvillimin e vendit. Qeveria e Kosovës e ka identifikuar sektorin minerar si shtyllën kryesore për ringjalljen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në fushën e industrisë ekstraktive dhe minierave Kosova tani përballet me sfida të mëdha mjedisore.

Kërcënimi më i madh për mjedisin dhe shëndetin e njeriut tani për tani e përbëjnë mbetjet industrial të krijuara në kohë të mëhershme dhe deponuar afër minierave apo impianteve industriale, por edhe mbeturinat që do të krijohen edhe në të ardhmen gjatë funksionalizimit të industrisë ekstraktive dhe minierave, nëse ato nuk do të menaxhohen nën kushtet e duhura.

Ndikimet kryesore të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut janë:

- kontaminimi i ujërave nëntokësore nga rrjedhja e metaleve nga deponitë e mbyllura;
- kontaminimi i sedimenteve dhe ujërave sipërfaqësore nga materialet e deponive të cilat shkaktojnë erozion të sipërfaqes së deponive si dhe të shkarkimit të ujërave të kontaminuara nëntokësor në sipërfaqe;
- kontaminimin e ajrit nga retë e pluhurit nga deponitë gjatë erërave në periudhat me mot të thatë,
- kontaminimi i tokës bujqësore nga deponimi i pluhurit të depozituar nga deponitë e mbyllura,
- Kontaminimi i hapësirave të banimit, rrugëve dhe shesheve publike nga shpërndarja dhe depozitimi i pluhurit nga deponitë.

Paralelisht me masat për rehabilitimin e deponive ekzistuese është i nevojshëm procesi i ristrukturimit të industrisë minerare në Kosovë duke zbatuar Strategjinë minerare 2010-2025, nga e cila parashihet edhe administrimi i mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare (zbatimi i Direktivës së BE-së 2006/21/EC).

Dokumenti i cili sygjeron formën e menaxhimit të mbeturinave nga industria e nxjerrjes së mineraleve është Strategjia minerare 2010-2025 dhe Udhëzimi Administrativ nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstraktive dhe minierave.

Udhëzimi Administrativ nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstraktive dhe minierave, është miratuar nga Ministri i MMPH dhe është plotësisht i harmonizuar me direktivën e BE-së, (Direktiva 2006/21/EC dhe Vendimin e KE 2009/359/EC),

Kërkesa për hartimin e një Ligji janë dalur nga forume dhe takime të ndryshme, profesionale të cilat kanë fokusuar se problemet me mbeturinat nga industria nxjerrjes minerare do të zgjidhte me bërjen e një Ligji për këto mbeturina nga industria e nxjerrjes së mineraleve.

Procesi i hartimit të koncept dokumentit për mbeturinat nga industria e nxjerrjes së mineraleve do të udhëhiqet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Institucione tjera relevante që ndërliken me këtë fushë.

2. Përshkrimi dhe definimi i çështjes/ problemit kryesor:

Mbeturinat nga industria nxjerrëse e mineraleve është një nga rjedhat/ burimet më të mëdha të mbeturinave në Kosovë por edhe në BE, ku vlerësohet të kalojë 400 milion ton në vit. Këto mbeturina përbëhen nga materialet gjeologjike të cilat janë hequr për të fituar qasje në burime minerale (p.sh. dherave dhe të djerrinës), dhe mbeturinat nga përpunimi i materialeve/ mineraleve, që përpunohen për të marrë nga to një produkt të shfrytëzueshëm (p.sh. mbeturinave shkëmbinjet dhe mbeturinat të tjera si skorije etj.).

Punimi i Koncept dokumentit për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare ka për qëllim harmonizimin e plotë të kushteve nga legjislacioni i BE-se dhe përafrimin e legjislacionit kombëtar me Acquis Communautaire e përfshirë në lëminë e mjedisit, si dhe zbatimin efektiv të legjislacionit mjedisor, sipas standardeve të BE-së. Ky koncept dokument do të merë për bazë dhe shqyrtim edhe legjislacionin ekzistues si; Ligjin për Minierat dhe Ligjin për mbeturina dhe në veçanti Udhëzimin administrativ nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstraktive dhe minierave.

Ky Koncept dokument hartohet si dokument ekskluziv për të transpozuar dispozitat e Direktivave të BE-së, ku janë paracaktuar masat, procedurat dhe udhëzimet për të parandaluar ose zvogëluar efektet negative në mjedis, në veçanti në ujë, ajër, tokë, florë, faunë dhe peizazh, dhe çdo gjë që rrezikon shëndetin e njeriut, e që vjen si rezultat i administrimit të mbeturinave nga industria ekstraktive dhe minierave. Përveq direktives, do të bëhet edhe transpozimi i dokumenteve si që janë:

- Commission Decision 2009/337/EC on the Criteria for the classification of waste facilities in accordance with Annex III, adopted on 20/04/09, published on 22/04/09 (L 102, page 7)
- Commission Decision 2009/335/EC on the Technical guidelines for the establishment of the financial guarantee, adopted on 20/04/09, published on 21/04/09 (L 101, page 25)
- Commission Decision 2009/360/EC completing the technical requirements for waste characterisation, adopted on 30/04/09, published on 1/05/09 (L 110, page 48)
- Commission Decision 2009/359/EC on the Definition of inert waste in implementation of Article 22 (1)(f), adopted on 30/04/09, published on 1/05/09 (L 110, page 46),
- Commission Decision 2009/358/EC on the Harmonisation, the regular transmission of the information and the questionnaire referred to in Articles 22(1) (a) and 18.

Mbeturinat që janë gjeneruar në proceset e nxjerrjes së mineraleve, trajtimit të tyre dhe të cilat tashti po shfaqin ndikime të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Gjithashtu edhe Ligji ekzistues për mbeturina është njëri nga dokumentet që do të orjentoj politikën e menaxhimit të mbeturinave që do të gjenerohen në të ardhmen me zhvillimin e industrisë së nxjerrjes minerare.

Problemi:

Objektet nga Industria e nxjerrjes minerare, si në Trepçë, Feronikel, Deva Gjakovë, KEK etj., kryesisht në pjesën veriore dhe lindore të Republikës së Kosovës përcijellet me një gjendje të

trashëguar dhe të rënduar të mbeturinave, inerte dhe aso të rrezikshme - toksike, të cilat në vazhdimësi atakojnë shëndetin e mijëra njerëzve dhe mjedisin.

Rrjedhat e lumenjve me prezence të acideve, emetimi i pluhurit, punët e pasiguruara në deponimin e mbeturinave që sot gjenerohen, deponitë e paqëndrueshme dhe që nuk janë mirëmbajtura përbëjnë rrezik të përditshëm për të gjithë popullatën që jetojnë afër tyre dhe atakon në formë të ndryshme dhe në vazhdimësi edhe mjedisin. Në zonat që konsiderohen më të kontaminuara, ujërat lokale janë të ndotura, tokat e punueshme të kontaminuara, prej nga shpërndajmë/emetojmë metale të rënda në zingjirin ushqimorë dhe bëjnë ndikim negativ në kushtet jetësore. Po ashtu ajri është i ndotur me pluhur që i shkakton dëme në sistemin respiratorë.

Komunat si e Mitrovicës, e Zveçanit, Obiliqit, Gracanicës, Gllogovcit, Hani i Elezit, por edhe vende të fshatra tjera janë ndër zonat më të prekura me ndotje (nga emetimet e pluhurit, ujrave dhe dheut i kontaminuar).

Andaj, është mëse e nevojshme dhe urgjente që të trajtohen si çështjet komplekse, ashtu edhe ato që kanë të bëjnë me të gjitha vend nxjerrjet e mineraleve dhe vend deponimet e mbeturinave industrial.

Deri me tani këto mbeturina janë menaxhuar kryesisht përmes dispozitave të vendosura në Udhëzimin Administrativ nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstraktive dhe minierave, i cili është miratuar nga Ministri i MMPH dhe është pjesërisht i harmonizuar me direktivën e BE-së 2006/21/EC. për mbeturinat ekstraktive dhe minierave.

Vlerësimet e shumta të eksperteve, që kanë shqyrtuar problemet e shkaktuar nga mbeturinat nga industria nxjerrjes së mineralëve, si dhe deponitë e këtyre mbeturinave, është konsideruar se kjo lëmi do të rregullohet edhe me legjislacion të veçantë kjo lëmi, atëherë do të bëhet një zgjidhje me e drejtë dhe më e qëndrueshme për menaxhimin e tyre.

Ky koncept dokument do të plotësojë fushën e menaxhimit të mbeturinave industrial dhe në përgjithësi do të kontribuojë në përcaktimin e orientimit për veprimet e nevojshëm për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, andaj rekomandimet nga ky koncept dokument do të bëhet pjesë e strukturës së sistemit për menaxhimin e mbeturinave si dhe akteve mjedisore që ndërliken me çështjen e mbeturinave industriale, si që janë:

Ligjet:

- Ligji Nr. 03/L-025, 2009, 10 Gusht 2011 -Ligji për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji për mbeturina 24 Shtator 2012 -Ligji për mbeturina
- Ligjin për mbrojtjen e natyrës 28 Maj 2013 -Ligjin për mbrojtjen e natyrës
- Ligji Nr. 03/L-230, 10 Gusht 2011 -Ligj për vlerësimin strategjik mjedisor
- Ligji Nr. 03/L-214, 10 Gusht 2011 -Ligj për vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Ligji Nr. 03/L-043, 2009 10 Gusht 2011 -Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes
- Ligji Nr. 02/L-116. 2007, 10 Gusht 2011 -Ligji për kimikate
- Ligjin Nr. L-012-2010, 25 Shkurt 2010 -Ligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, dhe

Aktet nënligjore:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2013 për vlerat kufitare të përqendrimeve për komponentët e rrezikshme në mbeturina
- Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2011 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme
- Udhëzim Administrativ Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimet e pasojave
- Udhëzim Administrativ për nivelin maksimal të lejuar të shkarkimit dhe të shpërndarjes të ndotësve në tokë
- Udhëzim Administrativ Nr.06/2008 për administrimin e mbeturinave të rrezikshme
- Për kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajnimin e mbeturinave Nr. 35/07.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave 25.06.2013 Udhëzimi.
- Udhëzim administrativ Nr. 25/2012 për leje mjedisore.
- Udhëzim administrativ nr. 20/2012 për export, import dhe tranzit të mbeturinave
- Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2012 për regjistrin e impianteve në të cilat është vërtetuar prezenca e substancave të rrezikshme.
- Udhëzim Administrativ Nr.10/2007 për administrimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ Nr.01/2009 mbi kushtet për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponisë së mbeturinave.

Mbeturinat nga industria nxjerrëse gjëndërohen në sasi më të mëdha ndaj mbeturinave tjera në Republikën e Kosovës, Ngjashëm ndodhe edhe me gjenerimin e mbeturinave në shtete anëtare të BE-së.

Ato përbëhet nga materialet gjeologjike të cilat janë hequr për të fituar qasje në burime minerale (p.sh. tokës dhe djerrinës), dhe mbeturinat nga përpunimi i materialeve të tilla për të marrë një produkt të shitshëm.

Shumica dërrmuese e këtyre mbeturinave /materialeve janë inerte, dhe menaxhohen nga operatori në vendin e prodhimit. Në Kosovë, një pjesë janë kthyer në vendet nga të cilat ato janë nxjerrë. Megjithatë, kjo nuk është gjithmonë e mundur për shkaqe teknike, ekonomike, lokacioni i pa përshtatshëm dhe kosto të larta etj.

Andaj mbeturinat janë vendosur në forme grumbujve pranë minierës apo guroreve, ndërsa materialet e prodhuara si mbetje të proceseve industriale (mbeturinë) janë depozituar posaçërisht, në formën e një lagune, pellgu, ose në forme të një deponie, kryesisht pak të menaxhuar.

Emri i deponisë	Vendi	Statuti i deponisë	Hapësira e mbuluar (ha)	Sasia e mbetjeve (t)
Gornji Kmjin	Leposaviq	E braktisur	6.5	2 600 000
Bostaniste	Leposaviq	Aktive	8 - 10	3 600 000
Zhitkovac	Zveçan	E braktisur	26	8 500 000
Gornje Polje	Zveçan	E braktisur	50	12 000 000
Gornje Polje	Zveçan	Llum plumbi – e braktisur	4 - 6	2 500 000
Zveçan	Zveçan	Pluhur – e braktisur	10 – 15	10 000 000
Kelmend	Kelmend	Aktive	8 - 10	3 600 000
Parku industrial i Mitrovicës	Mitrovicë	E braktisur	35	4 200 000
Staro Jalovishte	Graçanicë	E braktisur	40	11 000 000
Badovc	Badovc	Aktive	18	7 700 000
Artanë	Artanë	E braktisur	4	1 800 000
		Total	209.5 -220.5	67 500 000

Deponite e mbeturinave nga industria e nxjerrjes së mineraleve, janë deponi me sipërfaqe të përgjithshme përafërsisht **220.5** ha, që mbajnë **67 500 000** ton, dhe **40 000 000** ton në deponite e hirit në KEK, mbeturina të krijuar prej kohësh dhe ndikimet kryesore të tyre janë:

- kontaminimi i ujërave nëntokësore nën deponitë e mbyllura dhe nga rrjedhja e metaleve të rënda nga deponitë,
- kontaminimi i sedimenteve dhe ujërave sipërfaqësore nga materialet e deponive, të cilat shkaktojnë erozion të sipërfaqes së deponive si dhe të shkarkimit të ujërave të kontaminuar sipërfaqësore në ato nëntokësor.
- kontaminimin e ajrit nga retë e pluhurit nga deponitë, gjatë fryrjes së erërave.
- kontaminimi i tokës bujqësore nga deponimi i pluhurit të depozituar nga deponitë e mbyllura,
- Kontaminimi i hapësirave të banimit, rrugëve dhe shesheve publike nga deponimi i pluhurit të depozituar nga deponitë e mbyllura.

3. Synimet dhe Objektivat

Synimi i përgjithshëm është që të krijohen kushte për menaxhimin e rregullt dhe të qëndrueshëm të mbeturinave nga industria e nxjerrjes së mineraleve me këtë do të arrihet plotësimi i legjislacionit aktual me Direktiven e 2006/11/EC të Këshillit Evropian.

Qëllimi i propozimit është që të sigurojë masa shtesë në kuadrin e Direktivës Kornizëtë Mbeturinave 98/2008/EC për të parandaluar ose reduktuar sa më shumë të jetë e mundur, efekte negative në mjedis, dhe çdo rrezik rezultuese për shëndetin e njeriut, që do të rezultojë si rezultat i menaxhimit të mbeturinave nga industria nxjerrëse minerare.

Me hartimin e këtij Koncept dokumenti synohet krijimi i mekanizmave për monitorimin dhe kontrollin sa më të mirë të mbeturinave industriale. Gjithashtu ky ligj rezulton në plotësimin e synimeve të Qeverisë për zhvillimin e vendit duke rregulluar dhe kompletuar me akte ligjore, fushën e minierave dhe industrisë bazike të përpunimit të mineraleve, si fusha më perspektivë për zhvillimin

e vendit, synohet zbatimi i plotë i Ligjit për Miniera dhe legjislacionit mbështetës, si dhe zbatimi i Strategjisë minerare 2010-2025, dhe zbatimin e akteve ligjore për mjedisin.

Si objektiva nga ky dokument janë përcaktuar:

- Krijimi i kushteve për menaxhimin e rregullt dhe të qëndrueshëm të mbeturinave nga industrite e nxjerrjes së mineraleve.
- Sigurimi i masave për parandalimin e efekteve negative në mjedis.
- Krijimi i mekanizmave për monitorimin dhe kontrollin sa më të mirë të mbeturinave industriale.

4. Opsionet

Opsionet e parashtruara më poshtë e reflektojnë gjendjen ekzistuese e cila nuk i përmbushë kushtet dhe standardet e diskutuara, por po ashtu edhe mënyrat e përmirësimit të njëjtës.

Opsioni i parë: Opsioni asnjë ndryshim

Mos të behet ndryshimi i gjendjes aktuale nënkupton lënien në fuqi të gjendjes ekzistuese dhe legjislacionit e fuqi për këto mbeturina dhe sistemit aktual të administrimit të mbeturinave nga industria e nxjerrjes së mineraleve e cila nuk është funksionale dhe vazhdimisht vazhdon në degradim apo përkeqësim të gjendjes nga ndikimet e dëmshme të mbeturinave .

Grupi punues ka shqyrtuar mundësinë e mos ndryshimit të gjendjes lidhur me rregullat e vendosura me parë në Republikën e Kosovës për administrimin e mbeturinave nga industria e nxjerrjes së mineraleve. Po ashtu, kjo gjendje mund edhe të vazhdojë, por përkeqësim të gjendjes nga ndikimet e dëmshme të mbeturinave, sigurisht do të vazhdojë dhe rreziku nga deponite e mbeturinave do të jetë i vazhduar.

Opsioni i Dytë: Rregullimi i Pjesshëm i fushës së mbeturinave

Një opsion tjetër që është shqyrtuar gjatë përgatitjes së këtij koncepti dokumenti është edhe rregullimi i pjesshëm i fushës së për menaxhimin e mbeturinave nga industria e nxjerrjes së mineraleve

Grupi punues ka shqyrtuar mundësinë e ndryshimeve të pjesshëm, në fushën e administrimit të mbeturinave nga nxjerrja e mineraleve, e sidomos për ndryshimin e pjeserishëm Udhëzimin Administrativ nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstraktive dhe minierave.

Si opsion, ishte i mundshëm por jo edhe i mjaftuar sepse në legjislacionin e BE-së janë përcaktuar kondita të shumta dhe ato do të duhet harmonizuar.

Opsioni i Tretë: Hartimi i politikave të reja për fushën

Plotësimin dhe ndryshimi i politikave ekzistuese për për menaxhimin e mbeturinave në fjalë, respektivisht Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes së mineraleve në përputhshmëri të plote me Direktiven e 2006/21/EC të Komisionit dhe Këshilli Evropian.

Grupi punues ka shqyrtuar alternative për ndryshimin e politikave për mbeturina nga industria e nxjerrjes së mineraleve. Pasi që janë analizuar dhe shqyrtuar çështjet me ndikim në fushën përkatëse, është konstatuar se ndryshimi i politikave dhe harmonizimi i tyre me rregullat e BE-së mund të behet

vetëm duke Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes se mineraleve me te cilin ditë plotësohet me dispozita pozitive nëse krahasohet me UA –ne ekzistuese.

Hartimi i ligjit Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes mineraleve do te behet në përputhshmëri me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së për këtë fushe.

5. Përmbledhja e opsioneve:

Ruajtja e gjendjes ekzistuese që nënkupton mos ndryshimin e gjendjes aktuale në aspektin e menaxhimit e mbeturinave nga industria e nxjerrjes se mineraleve. UA ekzistues nuk do të jetë i përshtatur mire me kërkesat e direktivës së BE-se dhe gjithashtu nga aspekti procedurave i vlerësimit te rrezikut, ato nuk janë kompletuar. Kjo do te paraqet pengesa ne zhvillimin e aktiviteteve ne te ardhmen, sidomos për rehabilitimin e deponive ekzistuese, por edhe për vlerësimin mjedisore te vendeve eventuale qe do te përdoren për deponim te reja për këto mbeturina.

Mos mbështetja e propozimit, mbajtja e gjendjes ekzistuese do të nënkupton mos ndryshimin e gjendjes aktuale në aspektin e menaxhimit te mbeturinave nga industria e nxjerrjes se mineraleve dhe poashtu rezikimin e përhershëm te mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ndërsa vazhdimi i mëtutjeshëm me administrimin përmes Udhëzimit Administrativ ekzistues ose ndryshimin dhe plotësimin e tije, gjithashtu do të vazhdohej mbajtja e gjendjes pa perspektive për ndonjë zgjidhje më të mirë.

Hartimi Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare do te hapë debatin dhe negociatat e ndryshme me qëllim për të përmirësimit të cilësisë së aktit ligjorë dhe krijimin e kushte administrative me të qëndrueshme për menaxhimin e dejtë të mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare.

Plotësimi dhe ndryshimi i legjislacionit në fuqi sipas afateve të kërkuara do të kishte një efekt të duhur sepse do te përfshihen të gjitha dispozitat relevantë te direktivës së BE-së. sipas tabelës.

Tabela V- Përmbledhja e Opsioneve

Përmbledhja e opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1 Status-quo	Opsioni 2 plotësim ndryshimi i kornizës aktuale	Opsioni 3 Hartimi i Ligjit të ri
Karakteristikat kryesore të opsionit	Mos hartimi i Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare.	Vazhdimi i administrimit te mbeturinave të industrisë së njerrjes përmes Udhëzimi Administrative nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstraktive dhe minierave ose ndryshimin dhe plotësimin e tijë .	Hartimi i ligjit Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare në përputhshmëri me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së.
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar	Përfshihen të gjitha hapsirat dhe komunitetet në afërsi te minierave dhe industrisë së njerrjes minerare dhe në afërsi të	Përfshihen të gjitha komunitetet në afërsi te minierave dhe industrisë së njerrjes minerare dhe në afërsi të deponive	Përfshihen të gjitha komunitetet në afërsi te minierave dhe industrisë së njerrjes minerare dhe në afërsi të deponive

	deponive industriale ekzistuese	industriale ekzistuese	industriale ekzistuese
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	MZHE- kompanitë nxjerrëse dhe përpunuese, private dhe publike nën monitorimin e MMPH	MZHE- kompanitë nxjerrëse dhe përpunuese, private dhe publike nën monitorimin e MMPH	MZHE- kompanitë nxjerrëse dhe përpunuese, private dhe publike nën monitorimin e MMPH
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	MZHE	MZHE	MZHE
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Ligji për mbeturina Nr-04/L-060, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025. Kodi penal I Republikës së Kosovës	Ligji për mbeturina Nr-04/L-060, Udhëzimi Administrative nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstraktive dhe minierave Kodi penal I Republikës së Kosovës	Ligji për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare Kodi penal i Republikës së Kosovës
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat	Nuk ka	Nuk ka	Taksat për shfrytëzimin e xeheve Donatore për projekte mjedisore
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Takime me pale te interesit	Parashihet fushate promovuese	Parashihet fushate promovuese
Udhëzimet	Ne harmoni me legjislacionin e BE	Ne harmoni me legjislacionin e BE	Ne harmoni me legjislacionin e BE
Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni	Është ne fuqi Udhëzimi Administrative nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstrakteve dhe minierave	Është ne fuqi Udhëzimi Administrative nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstrakteve dhe minierave	Deri ne fund te viti 2017

6. Analiza e opsioneve

Opsioni i parë:

Opsioni status quo (asnjë ndryshim) – Pas analizës së këtij opsioni, nuk vërehet ndonjë përfitim i konsiderueshëm dhe i matshëm nga ky opsion.

Mbajtja e gjendjes së pa ndryshuar ose opsionin ‘mos bëni asgjë’, e cila nuk mundeson rregullimin e menaxhimit të mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare.

Mos përfshirja e obligimeve që dalin nga Acquis BE Communautaire për transpozimin e Legjislacionit të BE-së për menaxhimin e mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare dhe legjislacionin mjedisore ne përgjithësi. Në këtë rast UA nuk do të jetë i përshtatur me kërkesat e Direktivën e BE dhe gjithashtu nga aspekti i procedurave për menaxhimin e mbeturinave nga industria e nxjerrjes mineraleve.

Opsioni i dytë:

Rregullimi i Pjesshëm i administrimit te mbeturinave nga industria e nxjerrjes mineraleve sipas këtij

opsioni askush nuk do te përfitoj ne mënyre te drejte, mbikëqyrja do te jete jo e plote, nuk do ekzistojnë procedura adekuate ndëshkuese, rregulla te bollshme dhe adekuate për licencimin dhe marrjen e lejeve mjedisore etj, nga i njëjti opsin përfitimet janë vetëm për disa.

Mos mbështetja e propozimit, vazhdimi i administrimit të mbeturinave përmes Udhëzimi Administrative nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstraktive dhe minierave dhe mos zbatimi i tijë, ose ndryshimin dhe plotësimin e tijë, përkundër adaptimit dhe transpozimit te legjislacionit te BE-se, do të mbahet edhe me tej një gjendje jo funksionale (pse është jofunksionale?) për menaxhimin e mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare.

Opsioni i tretë:

Ndryshimi i politikës ekzistuese – Përfitimet konsistojnë në themelimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm të administrimit te mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare, caktimin e mekanizmit për mbikëqyrje dhe tranimet e vazhdueshme te operatorve, sistem te dhënie se lejeve. Nga ky Opsion do të përfitonin si institucionet kompanite dhe vete qytetarët e Kosovës në tërësi, sidomos nga aspekti i mbrojtjes së mjedist dhe shendetit.

Grupi punues dhe MMPH rekomandojnë si opsion me te arsyeshëm, Opsionin e trete qe është Hartimin e Ligjit të ri për te mbeturinat nga industria e nxjerrjes se mineraleve. Nxjerrja e Ligjit të ri nga i cili do të dalin edhe disa Rregullore, Udhëzime Administrative dhe udhëzues teknik për menaxhimin mbeturinave nga industria e nxjerrjes se mineraleve.

Qasja për të bërë ligj do të ishte në vijë të plotë me propozimet e shumëta dhe do te krijoj obligime me te qëndrueshme në përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullave për menaxhimin e mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare, dhe poashtu hapja e debatit dhe negocimit sipas nevojës për të krijuar mundësi për hartimin e një akti më të avancuar gjithsesi në përputhshmëri me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së.

Kostoja:

Ligji i propozuar ligji do të ndikojë në rregullimin të gjithë sektorët e biznesit të industrisë nxjerrëse.

Të dhënat më të fundit tregojnë se minierat dhe guroret kryesisht janë aktive në nxjerrjen e thëngjillit, rërës dhe zhavorrit, gurë gëlqeror dhe vullkanik dhe guroret që janë të lidhura me sektorin e agregateve të ndërtimit (p.sh. Rëre, gur gëlqeror, vullkanik etj.) dhe janë të shpërndara gjerësisht në të gjithë Kosovën, si dhe xeherore metali si të Nikelit dhe mineralet e Trepçës, eksploatimi i thëngjillit për industrinë e energjisë KEK dhe minerale industriale (p.sh. glina balta dhe rërë silikate).

Për te përmirësuar gjendjen ne fushën e minierave dhe deponive te mbeturinave Ndërmarrja e aktiviteteve Strategjine e mjedisit, për mbeturina ekzistuese nga industria e nxjerrjes minerare do të

ketë një kosto jashtëzakonisht të lartë për menaxhimin e mbeturinave nga industria e nxjerrëse minerare nëse do të llogaritet në rehabilitimin e deponive ekzistuese të mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare të krijuara me herët, disa nga këto projekte janë të paraqitura në tab:

Nr.	Lokacioni	Përshkrimi i intervenimit	Prioriteti	Kostoja (Euro)
i	Artanë	<ul style="list-style-type: none"> Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave acidike minerare në Artanë 	Shumë i lartë	~ 300 000
	Tuneli i parë	<ul style="list-style-type: none"> Studim i fizibilitetit për vlerësimin e kërkesave për trajtim (trajtim aktiv ose pasiv) Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujit të shkarkuar minerar nga njësia e flotacionit në Tunelin e parë 	I ulët	~ 15 000 ~ 300 000
ii	Parku industrial i Mitrovicës	Rehabilitimi i deponisë së parkut industrial të Mitrovicës <ul style="list-style-type: none"> Pastrimi i shtratit dhe i brigjeve të lumit Sitnica dhe ndërtimi i murit ndarës përgjatë mbetjeve industriale dhe lumit Rrethimi i mbetjeve industriale në parkun industrial të Mitrovicës (sipërfaqja 35 ha, shuma) Instalimi i gypave të drenazhes për mbledhjen e ujërave që rrjedhin nga materialet mbetje dhe transportim i tyre në impiantin për trajtimin e ujërave acidike. 	Shumë i lartë	~ 2 000 000 ~ 1 000 000 ~ 700 000
	Deponia e Kelmendit	<ul style="list-style-type: none"> Rrethimi i mëtejshëm dhe rikultivimi i deponisë së Kelmendit 	I lartë	~ 650 000
	Lokacioni metalurgjik dhe i llumit të plumbit në Zveçan	Përmirësimi dhe mbulimi i deponive në Gornje Poje dhe Zitkovac <ul style="list-style-type: none"> Pastrimi i shtratit dhe i brigjeve të lumit nga mbetjet industriale, duke përfshirë ndërtimin e mureve ndarëse mes deponisë dhe lumit Ibër për ta parandaluar bartjen e mbetjeve materiale, duke përfshirë mbulimin me shtresa të reja të tokës 	I lartë	~ 6 800 000
	Deponia e Graçanicës	Rehabilitimi i mëtejshëm i deponisë në Graçanicë <ul style="list-style-type: none"> Rrethimi dhe rikultivimi i deponisë në Graçanicë 	I lartë	~ 300 000
	Miniera e Artanës	Rrethimi i deponisë në Artanë (T2)	I mesëm	
iii	Rajoni i Mitrovicës	Rehabilitimi i tokës bujqësore dhe i hapësirave publike në rajonin e Mitrovicës <ul style="list-style-type: none"> Kryerja e hulumtimeve për ta vlerësuar kontaminimin e tokës bujqësore dhe heqja e kontaminimit Ndërmarrja e masave përmirësuese për zëvendësimin e shtresës së sipërme të dheut (15-25 cm) të tokës bujqësore, vendbanimeve dhe vendeve publike 	Shumë i lartë	~ 450 000 ~ 7 500 000 – 10 000 000
iv	Gjithandej Kosovës	Fushata të vetëdijesimit për promovimin e praktikave më të shëndosha në zonat e kontaminuara.	Shumë i lartë	500 000

Duke u bazuar në parimin, „ndotësi paguan në të ardhmen“ do të krijohen të ardhura nga eksploatimi i mineraleve, ku operatorët do të detyrohen të paguajnë një rente/taks për buxhetin e Kosovës që varionë në mes nga 0.1% dhe 1% të xhiros (me e verifiku këtë të dhënë), ose gjithashtu një tarifë të caktuar sigurimi për (aksidentet dhe për rehabilitim) mbyllet e planifikuar të deponive të projektuara dhe të lejuara.

Pagesa e sigurimit do të zbatohet për të gjithë operatorët të cilët dëshirojnë për të hapur një strukturë të re të menaxhimit (atyre që do të kërkojnë një leje) dhe pagesa do të shtrihet edhe te operatorët ekzistues.

Të gjithë operatorët do të duhet të japin një formë të Garancionit Financiarë (qoftë me anë të një kontrate ose mjete të tjera të pranueshme) tek autoriteti kompetent.

- Shuma e garancionit do të përcaktohet nga – Qeveria e Republikës së Kosovës, duke iu referuar;
kërcënimi mjedisor që vjen nga secili objekt;
- përdorimi i objektit pas mbylljes së saj në mënyrë për të vlerësuar koston e mundshëm të punës rehabilitimit;
- niveli i garancisë do të jetë i rishikuar pas çdo 5 vitesh, dhe veç e veç përpara mbylljes së objektit të menaxhimit, për të siguruar se vlera është e përshtatshme;

Pra, garancioni Financiar, ka për qëllim restaurimin e dëmit eventual mjedisor – d.m.th. Operacionet; pastrim pas ndotjes apo ndoqje incidentit dhe kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj pronës dhe / ose personave (në secilin rast) në rast të një dështimi të një strukturë/objekt për menaxhimin e mbeturinave.

Një garancion financiare është i nevojshëm vetëm nëse mbeturinat duhet të vendosen në një objekt të mbeturinave.

Kjo nuk mund të konsiderohet si një kosto e shtuar me rastin e funksionalizimit të objektit për vendosjen e mbeturinave, pasi që llogaritjet për garancionin janë bërë para se një aplikim /planifikim për nxjerrjen e mineraleve të jetë miratuar.

Megjithatë, edhe pse operatorët të paguajnë për taksat dhe sigurimet, përmes ligjit mund të përcaktohen edhe pagesa shtese. Objektet që bëjnë nën Kategorinë A në Aneksin II sipas Direktivës e 2006/11/EC do të jetë subjekt i kostove shtesë për të përmbushur kërkesat të imponuara mbi objekte të tilla nga Ligji.

Kostoja financiare të merret sipas deklaratës financiare në tab: që mund të konkludohen nga implikimet financiare sipas formës së plotësuar në Excel.

Formulari i Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor

7. Konsultimi

Për Hartimi e Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare është konsultuar ekspertin nga Universiteti Humboldt në Berlin i cili sygjëron se për një menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare, është i nevojshëm Ligji, Udhëheqës të Kombinatit Trepça persona brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe është arritur përfundimi se duhet të bëhet hartimi i Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare.

Po ashtu Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marr mendime lidhur me këtë koncept dokument edhe nga Ministrinë tjera.

Për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji janë konsultuar departamentet brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe është arritur përfundimi se duhet të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare.

Po ashtu, gjatë hartimit të këtij Koncept Dokumenti, grupi punues në kuadër të MMPH ka zhvilluar disa konsultime paraprake me disa institucione dhe palë të interesuara sikurse:

- Ministria e tregtisë dhe industrisë,
- Ministria e zhvillimit ekonomik,
- Ministria financave,
- Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
- Ekspertë të fushës,
- Agjensioi i Mbrojtjes se mjedisit te Kosovës

Nevoja për hartimin e ligjit ka rrjedhë gjate konsultimit edhe me komuna e prekura nga ndikimet e mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare, palët tjera që vlerësojnë gjendjen e vështirë dhe të pa menaxhuar sidomos të deponive për mbeturinat nga industria e nxjerrjes minerare.

Po ashtu janë shqyrtuar/ konsultuar edhe legjislacioni relevant i BE-së, është identifikuar nevoja hartimi e këtij Ligji, dhe zbatimi i tij.

Gjatë konsultimeve grupi në formë propozimit te shkruar është vlerësuar se nxjerrja e Ligjit është nevojë e qëlluar e cila do të jetë në pajtim me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullave në mbrojtën e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndotja me mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare.

Propozimi i këtij ligji do të ndikojë në të gjitha sektorët e industrisë së minierave dhe gurore. Këto gjerësisht mund të ndahen në ndërtimin (p.sh. rërës dhe zhavorrit, gurit gëlqeror, ranor), të energjisë (qymyr, linjit, naftës dhe gazit), metalmbajtës (p.sh. bakër, plumb, zink dhe nikel crom) dhe minerale industriale (p.sh. Glina, Balta, Rërë Silicit), si dhe deponimin e mbeturinave

Ndikimet kryesore do të jenë në ato objekte mbeturinave konsiderohen më shumë gjasa të shkaktojë rreziqe të rëndësishme mjedisore ose shëndetësore, ose kanë rrezikun më të madh të një aksidenti të rëndë.

Menaxhimi i rregullt i mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare do të shkaktojë efekte pozitive edhe për ndryshimet klimatike janë pjesë e politikës së Komunitetit Evropian, për të arritur një cilësi më të mirë të shëndetit të njeriut dhe për mbrojtjen e mjedisit.

8. Krahasimi i Opsioneve

Propozuesi ka shqyrtuar një sërë alternativa të mundshme për të gjitha opsionet e lartcekura, por dy opsionet e para nuk mund të vendosen sepse të mos beshes ndryshim fare, apo për një ndryshim të pjeserishem nuk do të jepte mundësi që fusha e mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare të menaxhohet sipas kërkesave dhe standardeve më të avancuara të BE-se.

Opsioni 1 dhe 2 nuk rekomandohet meqenëse është në fuqi që disa vite tashmë dhe si i tillë pas ndryshimeve të legjislacionit në nivel të BE-se, do të krijohen zbrastesi për implementimin e tij në praktikë. Për më tepër, ruajtja e status quo-së, apo ndryshim i pjeshem, në raport me miratimin e Projektligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare nuk do të jete të arsyeshme sepse me ligjin e ri do të përcaktohen kriteret e nevojshme për një administrim më të drejtë të mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare.

Grupi punës i ka shqyrtuar një sërë alternativash të mundshme. Opsioni i rekomanduar është Hartimi e Ligjit për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare që nënkupton opsionin e tretë, pasi që Udhëzimi Administrativ ekzistues nr. 21-2014 për mbeturinat e ekstraktive dhe minierave, nuk është zbatuar dhe gjendja për menaxhimin e mbeturinave nga industria e nxjerrjes minerare është mjaft e rëndë.

Kështu opsioni për hartimi e Ligjit për Mbeturina nga Industria e Nxjerrjes Minerare do të ishte si opsion më i përshtatshëm sepse parashihet që të futen kapituj të tërë të ri me shumë dispozita që më parë nuk ishin përfshirë në UA –ne ekzistues, andaj edhe kjo dikton që të hartohet Ligjit për për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare.

9. Rekomandim:

Rekomandimi që i bëhet Qeverisë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes këtij Koncept dokumenti është hartimi dhe miratimi i Ligjit për për mbeturina nga industria e nxjerrjes minerare, sipas kërkesave dhe standardeve të BE-se.

Bazuar në këtë koncept dokument, pas miratimit me vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovë, MMPH do të kryesoj grupin punës në të cilin do të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Ministrinë

tjera relevante, komfor Rregullores së Punës së Qeverisë.

Personi përgjegjës do të jetë Zyrtari i autorizuar i cili koordinon punën me Departamentet tjera të MMPH si dhe marrjen e opinionit të brendshëm për të filluar me konsultimet paraprake dhe publike me Ministrinë tjera.

10. Komunikimi

Komunikimi bëhet gjatë dy fazave të ndryshme e që janë – gjatë draftimit të këtij dokumenti por edhe në fazën pasi të jetë hartuar.

Për më tepër, një mundësi shtesë e cila po ashtu nuk kërkon fonde dhe i qaset një grupi të madh njerëzish, do të ishte komunikimi dhe informimi i komunave dhe popullatës përmes rrjetit të informimit që funksionon në kuadër të MMPH.

Para se të dërgohet në Qeveri për miratim drafti i parë i projektligjit do të publikohet në ueb-faqen e MMPH-së për qëllime të konsultimit të akterëve të tjerë të interesuar.

Po ashtu do të mbahen takime me palët e interesuara për plotësime eventuale të projektligjit të hartuar.